

Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Gjenevë sipas nenit 44 të Konventës.

Vëzhgime përfundimtare - Shqipëria

Tetor 2012

1. Komiteti, pasi mori në konsideratë raportin e dytë dhe të katërt periodik të Shqipërisë (CRC/C/ALB/2-4) në mbledhjen e 1738-të dhe 1739-të (shih CRC/C/SR.1738 dhe CRC/C/SR.1739) të mbajtur në 25 Shtator 2012, dhe të përshtatur në mbledhjen e tij të 1754-rt, të mbajtur në 5 Tetor 2012, hartoi rekomandimet përmbyllëse që vijojnë:

I. Hyrje

2. Komiteti mirëpret paraqitjen e raportit të palës shqiptare, si kombinim të raportit periodik të dytë dhe të katërt (CRC/C/ALB/2-4) si edhe formulimin e përgjigjeve e sqarimeve për çështjet përkatëse të kërkuara (CRC/C/ALB/Q/2-4/Add.1), të cilat mundësuan njohjen më të mirë të situatës së fëmijëve në Shqipëri. Megjithatë, ndërsa konsideroi informacionin shtesë të siguruar nga pala shqiptare pas dialogut, Komiteti me keqardhje tërheq vëmendjen në mungesën e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë në delegacionin shtetëror, gjë e cila vështirësoi dialogun në disa çështje dhe në veçanti, në çështjet ligjore.
3. Komiteti tërheq vëmendjen që rekomandimet e paraqitura këtu duhet të lexohen në vazhdimësi dhe lidhje me rekomandimet përfundimtare të Raportit fillestar sipas Protokollit Opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (CRC/C/OPAC/ALB/CO/1) dhe sipas Protokollit Opsional mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë (CRC/CO/OPSC/ALB/CO/1).

II. Masat e marra si edhe arritjet e shtetit palë:

4. Komiteti nënvizon miratimin e masave legislative që vijojnë:

- (a) Ligji No. 10347 mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Nëntor 2010;
- (b) Ligji No. 10221 mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shkurt 2010; dhe
- (c) Ligji No. 9669 mbi Masat kundër Dhunës në Familje në Dhjetor 2006.

5. Komiteti mirëpret ratifikimin e:

- (a) Protokollit Opsional të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura në Dhjetor 2008;
- (b) Protokollit Opsional të Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin si edhe pornografinë në Shkurt 2008;
- (c) Konventës mbi Mbrojtjen e të gjithë personave nga Zhdukja e Detyruar, në Nëntor 2007;
- (d) Protokollit i parë dhe i dytë i Konventës ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, në tetor 2007;
- (e) Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Migrantëve për arsye pune si edhe të anëtarëve të familjeve të tyre, në qershor 2007;

(f) Konventës së Hagës No. 23 mbi njohjen e Vendimeve të Detyruara në lidhje me mbajtjen e detyrimeve në Gusht 2011.

6. Komiteti gjithashtu mirëpret masat e mëposhtme institucionale dhe politike:

- (a) Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, miratuar në Qershor 2011;
- (b) Emërimin e Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, në Maj 2010;
- (c) Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikut të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve të Trafikuar, miratuar në Korrik 2008; dhe
- (d) Krijimin e Njërive të Mbrojtjes së Fëmijëve në 28 bashki dhe komuna.

III. Fushat kryesore të interesit dhe rekomandimet:

A. Masa të përgjithshme të zbatueshme (nenet 4, 42 dhe 44, paragrafi 6 i Konventës)

Legjislacioni

10. Komiteti këshillon shtetin palë që të sigurojë se Ligji mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të zëvendësojë legjislacionin ekzistues dhe t'ju sigurojë fëmijëve të drejtat. Komiteti gjithashtu këshillon shtetin palë që të ndërtojë meknizmat, strukturat dhe sistemet e përshtatshme, që mundësojnë një zbatim efektiv të ligjeve mbi fëmijët në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Politika dhe strategji gjithëpërfshirëse

12. Komiteti inkurajon shtetin palë që të integrojë Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015 në politika përfshirëse të fëmijëve, të cilat duhet të përfshijnë të gjitha planet e veprimit për fëmijë, sektoriale apo rajonale. Komiteti gjithashtu këshillon shtetin palë që të sigurojnë të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe financiare për një zbatim efektiv të Planit për Fëmijë 2012-2015 dhe të sigurojnë konsultime të rregullta e të vazhdueshme për vlerësimin e efektivitetit në zbatim.

Koordinimi

14. Komiteti këshillon shtetin palë që të forcojnë rolin koordinues të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve nëpërmjet dhënies së një statusi të lartë kësaj agjencie, me një autoritet të mjaftueshëm dhe me burime të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të koordinuar veprimet për të drejtat e fëmijëve ndërmjet sektorëve, dhe në nivel kombëtar dhe lokal. Komiteti gjithashtu këshillon shtetin palë që të lehtësojë punën e shumë strukturave të të drejtave të fëmijëve dhe t'ju sigurojë atyre burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, për kryerjen e misionit me efikasitet.

Burimet

16. Komiteti gjithashtu këshillon shtetin palë që të:

- (a) Kryejë një vlerësim të gjithanshëm të buxheteve që ju nevoiten fëmijëve dhe rezervimin e burimeve buxhetore të mjaftueshme, në përputhje me nenin 4 të Konventës për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, dhe në mënyrë të veçantë të rrisë buxhetet e rezervuara në sektorët

socialë, përfshirë sektorin e arsimit si dhe të identifikojë ndarjen e pabarabartë të buxheteve bazuar në treguesit e të drejtave të fëmijëve.

(b) Përdorë përjasjen e të drejtave të fëmijëve në hartimin e buxhetit të shtetit, nëpërmjet zbatimit të një sistemi efektiv për rezervimin dhe përdorimin e burimeve për fëmijë, me pasojë rritjen e investimeve për fëmijë dhe përdorimin e buxheteve me efektivitet si edhe analizën efektive të investimeve të kryera në secilin sektor në raport me plotësimin më të mirë të interesave të fëmijëve, ndërkohë që të sigurohet matja e ndikimit të investimit, barazisht si tek djemte dhe vajzat;

(c) Autoritetet lokale të sigurojnë një transparencë dhe buxhetim me pjesëmarrje, nëpërmjet një dialogu me publikun, veçanërisht me fëmijët;

(d) Përcaktojnë linja buxhetore për fëmijë në situata të disfavourshme apo vulnerabël, e që kërkojnë masa sociale të miratuara, dhe të sigurohen që këto linja buxhetore të jenë të paprekshme/të mbrojtura edhe në rastet e situatave të krizës ekonomike, fatkeqësive natyrore apo çdo lloj emergjence;

(e) Marrin masa imediate për të luftuar korrupsionin dhe të fuqizojnë kapacitetet institucionale që efektivisht identifikojnë, investigojnë dhe dënojnë korrupsionin; dhe

(f) Marrin në konsideratë rekomandimet e “Ditës së Diskutimeve të Përgjithëshme” të vitit 2007 mbi “Burimet për të drejtat e fëmijëve dhe Përgjegjësitë e shteteve”.

Mbledhja e të dhënave

18. Komiteti inkurajon shtetin palë që të fuqizojë përpjekjet në ndërtimin e një sistemi të plotë për mbledhjen e të dhënave, duke bashkëpunuar edhe me partnerë të tjerë, të analizojë të dhënat e mbledhura për të vlerësuar/matur progresin e arritur në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ndërtimin e politikave e programeve në zbatim të Konventës dhe Protokolleve përkatëse. Të dhënat duhet të përfshijnë fëmijët deri 18 vjeç dhe duhet të jenë të ndara ndër të tjera sipas grupmoshës, gjinisë, zonës urbane/rurale, etnisë, kushteve ekonomike dhe sociale, duke mundësuar analizën e situatës për të gjithë fëmijët.

Monitorimi i pavarur

20. Komiteti kërkon nga shteti palë që të jetë i vëmëndshëm ndaj komentit No. 2 (CRC/GC/2002/2), në garantimin që Zyra e Ankesës për qytetarët dhe në mënyrë të veçantë departamenti tij për Fëmijët, të funksionojë me efikasitet, pa ndërprerje dhe të jetë qartësisht e dukshme që ky departament është i mbështetur me burimet e duhura njerëzore, financiare dhe teknike. Komiteti gjithashtu kërkon nga shteti palë që të marrë masat e nevojshme në realizimin e programeve ndërgjegjësuese, veçanërisht për fëmijët, përfshirë edhe ata që jetojnë në zonat e thella rurale, duke ju mundësuar ankiminin/dëgjimin nga Departamenti i Fëmijëve.

Propogandimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

22. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të marrë më shumë masa aktive për shpërndarjen dhe propogandimin e Konventës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve tek një publik më i gjërë dhe tek fëmijët, në mënyrë të veçantë.

Kualifikimi

24. Komiteti inkurajon shtetin palë që të garantojë se të gjithë grupet profesioniste që punojnë me dhe për fëmijët e veçanërisht zyrtarët në zbatimin e ligjit, punonjësit socialë dhe personeli që punon në institucionet e përkujdesit për fëmijë, janë në mënyrë të mjaftueshme dhe sistematikisht të kualifikuar. Në këtë kuptim, Komiteti rekomandon që edukimi mbi të drejtat e njeriut të jetë i përfshirë edhe në programet e të gjitha niveleve të arsimimit dhe në aktivitetet e kualifikimit e formimit profesional.

C. Parime të përgjithshme (nenet 2, 3, 6 dhe 12 të Konventës)

28. Komiteti kërkon nga shteti palë që të sigurojë se programet e tij trajtojnë me prioritet situatën e diskriminimit ndaj vajzave, fëmijëve që i përkasin minoriteteve etnike, fëmijëve që jetojnë në zonat rurale dhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Komiteti kërkon nga shteti palë që të përfshijë në informacionin e raportit të ardhshëm periodik edhe masat e programet që lidhen me Konventën dhe në veçanti për situatën e fëmijëve Romë të ndërrmarre nga shteti palë në vazhdim të Deklaratës dhe Programit Veprues, adoptuar në Konferencën Botërore të 2001 kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerances dhe të dokumentit të adoptuar në 2009 në Konferencën e Rishikimit në Dubai.

Interesi më i mirë i fëmijëve

30. Komiteti kërkon nga shteti palë që të:

- (a) Fuqizojë përpjekjet me qëllim që parimi i interesit më të mirë për fëmijët të jetë i integruar në mënyrë korrekte dhe të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha procedurat legjislativë, administrative dhe juridike, si edhe në të gjitha politikat, programet dhe projektet që aplikohen apo kanë ndikim tek fëmijët;
- (b) Sigurojë gjykime me instruksione të qarta për aplikimin e parimit të interesit më të mirë të fëmijës në procedurat e birësimit dhe të sigurojë që vendimet të jenë marrë në kohën e duhur, kështu që fëmijët të mos qëndrojnë për një kohë të gjatë në institucione; dhe
- (c) Zhvillojë procedura dhe kriteret që ofrojnë mbështetje dhe kontroll në përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijëve në çdo fushë dhe t'i shpërndajë ato në institucionet publike dhe private të mirëqënies sociale, gjykatat, autoritetet administrative dhe strukturat legjislativë. Të gjitha gjykimet gjyqësore dhe ato administrative, duhet të jenë të bazuara në parimin e interesit më të mirë të fëmijës.

E drejta për jetesë, mbi-jetesë dhe zhvillim

32. Komiteti kërkon nga shteti palë që të marrë masa të prera dhe efektive për dhënien fund të “gjakmarrjes” dhe të “ngujimit” të familjeve dhe fëmijëve, dhe veçanërisht të “identifikojë” këto familje e t'i mbështesë sa më shumë me forma të pajtimit, nga udhëheqësit e komuniteteve sipas rekomandimeve të Raportuesit Special. Për më tepër, Komiteti kërkon nga shteti palë që të marrë të gjitha masat për investigimin e rasteve të gjakmarrjes dhe të sigurojë një gjykim korrekt të autorëve.

Respektimi i pikpamjeve/mendimit të fëmijëve

34. Bazuar në komentin e përgjithshëm No. 12 (CRC/C/GC/12, 2009), Komiteti kërkon nga shteti palë që të:

(a) amendojë legjislacionin me qëllim që e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar të aplikohet në çdo çështje civile apo penale dhe në procedurat administrative që prekin fëmijët dhe kjo e drejtë t'ju jepet në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës;

(b) fuqizojë përpjekjet për sigurimin që fëmijët të kenë të drejtën e shprehjes lirisht të pikpamjeve/mendimit në të gjitha çështjet që ata preken dhe që pikpamjet/mendimet e fëmijëve të kenë peshën e duhur në shkolla apo institucione të tjera edukuese, dhe në familje, si edhe reduktim i pabarazive në mundësi për pjesëmarrje të fëmijëve/nxënësve që i përkasin grupeve shoqërore të ndryshme dhe nga rajone të ndryshme; dhe

(c) luftojë fuqimisht sjelljet të cilat pengojnë të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar, nëpërmjet programeve dhe fushatave edukuese për publikun, duke përfshirë shtypin dhe median dhe duke i dhënë rëndësi të veçantë situatës së fëmijëve të përjashtuar apo në rrezik përjashtimi, nga minoritetet, fëmijë që jetojnë në zonat rurale dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

D. Të drejtat civile dhe liria (nenet 7, 8, 13-17, 19 dhe 37 (a) të Konventës)

Regjistrimi në lindje

36. Komiteti kërkon nga shteti palë që të vazhdojë dhe fuqizojë me prioritet, përpjekjet për ndërtimin e një sistemi që garanton regjistrimin e të gjithë fëmijëve që lindin në territorin e tij dhe ky regjistrim është falas. Shteti duhet gjithashtu urgjentisht të lëshojë instruksione të qarta në të gjitha shkollat, në të gjithë territorin, me qëllim që të gjithë fëmijët, pavarësisht statusit të regjistrimit, të mund të regjistrohen në shkollat publike dhe se çdo dështim në regjistrim në shkollë, mund të çojë në aplikimin e sanksioneve administrative.

Aksesi ndaj informacionit të duhur

38. Komiteti i rekomadon shtetit palë që të marrë të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo informacion i dëmshëm, veçanërisht nga programet televizive, e të garantojë informacionin e duhur e promovojë programe edukative cilësore, në të cilat fëmijët dhe të rinjtë të mund të përfshihen në mënyrë direkte.

E. Dhuna ndaj fëmijëve (nenet 19, 37 (a), 34 dhe 39 të Konventës)

Tortura dhe çdo trajtim apo ndëshkim i egër, jo-njerëzor apo degradues.

40. Komiteti i rekomandon shtetit palë:

(a) Investigim të plotë të të gjitha denoncimeve për keq-trajtim të fëmijëve, duke garantuar që veprime të tilla të marrin përgjigjen e duhur, nëpërmjet një procesi gjyqësor, me qëllim shmangien e pa-dënueshmërisë së dhunuesit;

(b) Të sigurojnë që të gjithë fëmijët e privuar, përfshirë edhe ata të vendosur në struktura të vuajtjes së dënimit, të kenë akses ndaj një mekanizmi ankues, ku ata të depozitojnë ankesën ndaj deprivimit/heqjes së lirisë, konditave të vuajtjes së dënimit;

(c) Të sigurojnë se fëmijët, viktima të keqtrajtimit, janë trajtuar me programe përkujdesi dhe rehabilitimi; dhe

(d) Të sigurojnë rregulla specifike dhe supervizim për policinë, forcat e sigurisë dhe rojtarët e burgjeve, lidhur me përkujdesin, mbrojtjen e fëmijëve nën përgjegjësinë e tyre.

Ndëshkimi fizik

42. Në vazhdim të komentit të përgjithshëm No. 8 (CRC/C/GC/8, 2007), Komiteti kërkon që shteti palë të:

- (a) Sigurojë se ndalimi i dhunës fizike është i zbatueshëm dhe se procese ligjore ndërrmerren në mënyrë sistematike kundër personave që ndëshkojnë fizikisht fëmijët;
- (b) Përmirësojë ligjin mbi Arsimin Para-Universitar, veçanërisht nëpërmjet forcimit të mekanizmave ligjorë për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve në ambientet e shkollës, saksione ndaj mësuesve që ushtrojnë dhunë si edhe procedura për të identifikuar e raportuar dhunën;
- (c) Inicijojë në mënyrë të vazhdueshme edukimin e publikut, ndërgjegjësimin e tij dhe programe të mobilizimit social, duke përfshirë fëmijët dhe familjet e tyre, drejtuesit e komuniteteve dhe median mbi efektet e dëmshme fizike dhe psikologjike të ndëshkimit fizik, me qëllim ndryshimin e sjelljes ndaj kësaj praktike; dhe
- (d) nxitjen e formave positive jo-të dhunshme dhe të formave alternative të disiplinimit dhe edukimit.

Abuzimi dhe neglizhimi

44. Në vazhdim të komentit të përgjithshëm No. 13 (CRC/C/GC/13, 2011) Komiteti kërkon që shteti palë të ketë si prioritet eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe gjinisë. Në veçanti Komiteti kërkon nga shteti palë të:

- (a) Adoptojë me prioritet ligjin që konsideron “krim” të gjitha format dhunës brënda familjes, përfshirë përdhunimin nga bashkëshorti dhe të rishikojë definicionin/përkufizimin e neglizhimit në Kodin Penal me qëllim mbulimin e të gjitha formave të neglizhimit të fëmijëve dhe të mundësojë një ndëshkueshmëri ndaj dhunës kundrejt fëmijëve;
- (b) Ndërtojë një sistem multi-sektorial eficient për mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe integrimin e fëmijëve viktime nga çdo lloj forme e dhunës; dhe
- (c) Përcaktojë procedura dhe mekanizma për identifikimin, raportimin, referimin, investigimin, trajtimin dhe koordinimin e rasteve të fëmijëve viktime të dhunës dhe ofrimin për fëmijët të një informacioni konkret se si ata të kërkojnë ndihmë.

Shfrytëzimi, abuzimi seksual dhe abuzimi

46. Komiteti kërkon që shteti palë të rishikojë legjislacionin dhe të sigurojë që fëmijët deri 18 vjeç të jenë të mbrojtur ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të adoptojnë programe dhe politika për parandalimin, rikuperimin dhe rehabilitimin e fëmijëve viktime të abuzimit apo shfrytëzimit seksual në përputhje me dokumentin e adoptuar në 1996, 2001 dhe në 2008 në Kongresin Botëror kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve, mbajtur respektivisht në Stokholm, Yokohama dhe Rio de Janeiro.

Praktikat dëmtuese

48. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të përcaktojë me ligj një moshë kufi për martesën dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të reduktuar praktikat e dëmshme të martesave të detyruara në moshë të hershme, përfshirë zhvillimin e programeve dhe fushatave të

ndërgjegjësimin mbi ndikimin negativ të martesave të detyruara në moshë të hershme, duke përfshirë drejtuesit lokalë, shoqërinë në tërësi dhe fëmijët.

Lirimin e fëmijëve nga çdo lloj forme të dhunës

49. Duke kujtuar rekomandimin e studimit të Kombeve të Bashkuara mbi dhunën ndaj fëmijëve (A/61/299), Komiteti i rekomandon shtetit palë që me prioritet të eliminojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve. Komiteti më tej i rekomandon shtetit palë që marrë në konsideratë Komentet e Përgjithëshme No. 13 (CRC/C/GC/13, 2011) dhe në veçanti:

- (a) Të zhvillojnë një strategji kombëtare gjithë-përfshirëse për parandalimin dhe adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve;
- (b) Adoptojë një kornizë koordinimi në nivel kombëtar për adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve;
- (c) T'i kushtojë vëmendje dhunës me bazë gjinore; dhe
- (d) Kooperojë me Përfaqësuesin Special në Sekretarinë e Përgjithëshme për dhunën ndaj fëmijëve dhe me institucione të tjera të Kombeve të Bashkuara.

“Linjat” e Ndhmës

51. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të bashkëpunojë me “ALO 116”, ndër të tjera, duke siguruar mbështetje financiare dhe teknike. Komiteti gjithashtu rekomandon se shteti palë duhet të njohë dhe pranojë linjat e ndihmës si një burim informacioni dhe të dhënash për politikën dhe legjislacionin e të drejtave të fëmijëve, si edhe një mekanizëm për ndërhyrje të hershme e parandalim, e të sigurojë që fëmijët janë në dijeni, kanë akses në këto linja dhe ju sigurohet një trajtim i përshtatshëm.

F. Ambienti familiar dhe përkujdesi alternativ (nenet 5, 18 (paragrafi 1-2), 9-11, 19-21, 25, 27 (paragrafi 4 dhe 39 i Konventës)

Ambienti familiar

53. Komiteti kërkon nga shteti palë që të:

- (a) Ndërtojë programe që mbështesin prindërit apo kujdestarët dhe t'i bëjnë ata të njohin praktika të mira të mirëritjes së fëmijëve të bazuara në njohjen e të drejtave të fëmijëve, zhvillimin e fëmijës dhe metodat pozitive të disiplinimit, me qëllim mbështetjen e familjeve me njohuri dhe kapacitete për t'ju siguruar fëmijëve një përkujdes dhe një ambient të sigurtë;
- (b) Promovimin e fushatave ndërgjegjëse me qëllim parandalimin e deprivimit të fëmijëve nga kujdesi i nënës për shkak të aplikimit të “Kanunit” dhe të sigurojë që interesi më i lartë i fëmijës është zbatuar në të gjitha rastet që lidhen me kujdestarinë dhe kontaktet;
- (c) Ndërtimin e një strukture e të një sistemi që lehtëson marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe dy prindërve pas divorcit dhe të sigurojë që përgjegjësitë e prindërve për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës janë të ndërtuara qartësisht, duke zbatuar në të gjitha rastet e në çdo rrethanë interesin më të lartë të fëmijës; dhe
- (d) Të marrë të gjitha masat e duhura që vendimet mbi detyrimin financiar janë zbatuar dhe të sigurojë me ligj që masa e pagesës të rishikohet në përputhje me nevojat në rritje të fëmijës, interesit të tij më të mirë dhe situatën e prindit (nënës/babait).

Fëmijët e deprivuar nga ambienti familiar

55. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të marrë të gjitha masat e nevojshme që fëmijët e familjeve të marginalizuara të rriten me prindërit biologjikë, në këtë kuptim të rrisë mbështetjen financiare për familjet në nevojë e t'i kombinojë me shërbime sociale të përshtatëshme për ta.

Komiteti kërkon nga shteti palë që:

- (a) Të amendojë dekretin No. 209 të 12 Prillit të 2006, duke ndaluar vendosjen e fëmijëve në institucione për arsye ekonomike;
- (b) Të kenë prioritet format mbështetëse të tipit familje, kundrejt strukturave institucionale e ndër të tjera të rrisin ndërgjegjësimin e publikut rreth dëmeve që shkakton institucionalizimi tek zhvillimi i fëmijëve;
- (c) Marrjen e të gjitha masave të nevojshme që koha e qëndrimit të fëmijës në institucione të ulët, nëpërmjet rishikimit periodik të qëndrimit në institucion, sipas nenit 25 të Konventës;
- (d) Të sigurojë që fëmijët të mos jenë më të ndarë nga motrat/vëllezërit dhe se ata rriten në një mjedis të sigurtë që ju favorizon krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve positive me të rriturit dhe fëmijët;
- (e) Gjatë procesit të rishikimit periodik, të zgjasë moshën e qëndrimit në përkujdes nga 15 në 18 vjeç dhe të sigurojë që fëmijët që lënë përkujdesin/institucionin të jenë të mbështetur me ndihmën e duhur;
- (f) Të sigurojë që përkujdesi në strukturat alternative të përkujdesit të jetë i paisur me burimet e duhura njerëzore, teknike dhe financiare për kujdesin e duhur ndaj fëmijëve; dhe
- (g) Të harmonizojë legjislacionin me Udhëzimet për Kujdesin Alternativ të fëmijëve bashkëngjitur Rezolutës së Asamblesë së Përgjithme të Kombeve të Bashkuara Nr. 64/142 si edhe Nr. 20, Dhjetor 2009.

Birësimi

57. Komiteti i kërkon shtetit palë që të rishikojë rregullat dhe procedurat e birësimit me qëllim që:

- (a) të sigurojë që fëmijët nën 10 vjeç e të abandonuar, të kenë të drejtën që të dëgjohen në procedurat e birësimit dhe se pikpamjeve të tyre ju është dhënë pesha e duhur në përputhje me moshën dhe maturinë;
- (b) të njihet e drejta prindërve biologjikë për të qënë të informuar dhe të këshilluar;
- (c) të vendoset një definicion tepër i qartë i termit “mungesë evidente/dukshme interesi” në nenin 250 të Kodit Familiar;
- (d) të përcaktojë procedurat që duhen ndjekur nga Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe qartësimin e përgjegjësive ndërmjet Komitetit dhe institucioneve të përkujdesit, lidhur me deklaratën e abandonimit të dukshëm të fëmijëve; dhe
- (e) të sigurojë që gjykatat marrin vendime lidhur me birësimin brënda një kohe të arsyeshme, dhe që janë përgjegjëse për përmbushjen e përgjegjësive në rastet e mosfunktionimit/shkeljeve.

G. Aftësia e kufizuar, shëndeti bazë dhe mirëqënia (nenet 6, 18 (paragrafi 3), 23, 24, 26, 27 (paragrafet 1-3) të Konventës)

Fëmijët me aftësi të kufizuar

59. Në frymën e komenteve të përgjithëshme (CRC/C/GC/9, 2006), Komiteti i rekomandon shtetit palë që të adresojë me prioritet situatën ekstremisht të marginalizuar të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në mënyrë të veçantë Komiteti ju rekomandon shteteve palë që (CRC/C/ALB/CO/2-4 15) të:

- (a) Ndërmarrin një program ndërgjegjsimi afat-gjatë me qëllim ndryshimin e sjelljeve negative të shoqërisë, ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- (b) Ndërtimin e mekanizmave për zbulim të hershëm dhe për ndërhyrje me shërbime multi – disiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, si edhe për rritjen e aksesit në arsimin parashkollor;
- (c) Të sigurojë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar, përfshirë ata me probleme mendore, të dëgjimit apo të folurit, të përfitojnë mbështetje financiare dhe përkujdes nga shteti dhe se kjo mbështetje nuk duhet të jetë më e kufizuar për një fëmijë në çdo familje;
- (d) Ndërtojë një Strategji Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar, që nxit respektimin e të gjitha të drejtave njerëzore dhe liritë bazë për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe me fokus të veçantë marrjen në kohë të masave për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuar kanë akses në arsimin normal; dhe
- (e) Të ratifikimit të Konventës së Personave me Aftësi të Kufizuar.

Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore

61. Komiteti i kërkon shtetit palë që të prioritarizojë shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore në sektorin e shëndetit me qëllim sigurimin e një aksesit të barabartë në shërbime shëndetsore të cilësishme për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët që jetojnë në zonat e largëta dhe Fëmijët Romë. Në veçanti, Komiteti i rekomandon shtetit palë:

- (a) Shtimin e përjekjeve për të adresuar keq-ushqyerjen, duke u fokusuar mbi të gjitha tek kategoritë e fëmijëve të përjashtuar si dhe tek edukimi i të ushqyerit dhe aksesit ndaj një ushqimi të cilësishëm;
- (b) Të sigurojnë që fëmijët Romë janë të paisur me kartë shëndetsore dhe marrin një shërbim shëndetsor efektiv dhe të pakufizuar (CRC/C/ALB/CO/2-4) 16;
- (c) Të sigurojë që fëmijët kane akses ndaj shërbimeve shëndetsore pa qënë të kondicionuar nga përkatësia e nënës si përfituese e sigurimeve shoqërore;
- (d) Të marrin masa që të luftojnë praktikatat e punonjësve të shëndetsisë dhe mjekëve për të marrë pagesa të paligjshme/rryshfete;
- (e) Fuqizimin e lidhjeve ndërmjet shërbimeve të nënës me ato të fëmijëve, përfshirë edhe institucionet pediatrike, dhe bashkëpunimin e këtyre institucioneve me ato të fëmijërisë së hershme;
- (f) Fuqizimin e përpjekjeve për nxitjen e ushqyerjes ekskluzive me gji deri në 6 muaj, nëpërmjet ndërgjegjsimit të personelit shëndetsor dhe të publikut mbi rëndësinë e ushqyerjes ekskluzive me gji; dhe
- (g) Marrjen e masave për adresimin e ndotjes së ajrit dhe kontaminimin e ujit të pijshëm.

Shëndeti i adoleshentëve

63. Në frymën e komentit të përgjithshëm No. 4 (CRC/GC/2003/4), Komiteti i kërkon shtetit palë që të:

- (a) Adoptojë standarte për shërbime shëndetsore miqsore për adoleshentët si edhe ndërtojë një strategji për zbatimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve;
- (b) Adresojë incidencën e përdorimit të drogës, duhanit dhe alkolit nga fëmijët dhe ndër të tjera ofrimin e informacionin të duhur fëmijëve rreth abuzimit me substancat, përfshirë edhe duhanin, si edhe zhvillimin e trajtimeve miqsore e të specializuara kundër drogës dhe të shërbimeve për reduktimin e dëmit;
- (c) Në bashkëpunim me OJF, fuqizimin e trainimit të mjekëve të përgjithshëm, infermierëve, punonjësve socialë si edhe të punonjësve të tjerë që operojnë në fushën e promovimit të shëndetit, të stileve të shëndetshëm të jetës dhe të mirëqënies emocionale të adoleshentëve, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve dhe të cilësisë së profesionistëve të shëndetit në vënd; dhe
- (d) Zhvillimin e një politike të gjërë të shëndetit mendor, përfshirë edhe nxitjen e shërbimeve me pacientë të jashtëm dhe pacientë të shtruar, për adoleshenët me problem të shëndetit mendor, si edhe të programeve që mbështesin familjet në risk.

HIV/AIDS

65. Në frymën e komentit të përgjithëm No. 3 (CRC/GC/2003/3) dhe të udhëzimeve ndërkombëtare për HIV/AIDS dhe të Drejtat e Njeriut, Komiteti ju rekomandon shteteve palë që (CRC/C/ALB/CO/2-417) të sigurojnë një sistem të testimit vullnetar për HIV/AIDS duke siguruar një respektim të plotë të të drejtës të ruajtjes së informacionit privat dhe konfidencialitetit dhe të përmirësojë sistemin e vëzhgimit për njohjen e rasteve të HIV/AIDS. Komiteti gjithashtu rekomandon që shërbimet që prandalojnë trasmetimin e HIV/AIDS nga nëna tek fëmija të jenë të integruara në sistemin shëndetsor. Komiteti më tej rekomandon që shteti palë të fuqizojë veprimet parandaluese mes të rinjëve, duke targetuar adoleshentet në kushte vulnerabël, si edhe të sigurojë që programe të edukimit mbi HIV/AIDS të sigurohen në shkollat e mesme e që fëmijët me HIV/AIDS të lejohen të ndjekin shkollën pa qenë të diskriminuar.

Standartet e jetesës

67. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të reformojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ndërmarrë ndryshime strukturale me qëllim adresimin e varfërisë së fëmijëve, përfshirë aksesin me prioritet të familjeve dhe fëmijëve në risk, dhe duke i kushtuar vëmëndje të veçantë familjeve të etnisë Rome dhe familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në këtë drejtim Komiteti i rekomandon shtetit palë, që t'ju japë të gjitha familjeve pagesë për fëmijë si një formë përfitimi universal dhe që ndihmat/tranferrat në para për familjet e varfëra të jenë të kombinuara me masa që mundësojnë punësimin e grave dhe të fëmijëve pas përfundimit të shkollës, të formimit profesional, strehimit, transportit dhe përfitimeve të tjera.

Komiteti gjithashtu i rekomandon shtetit palë të garantojë që punonjësit socialë janë të mirë trainuar, marrin një pagë të mjaftueshme dhe janë qartësisht të instruktuar në identifikimin e familjeve e fëmijëve në risk, janë në gjëndje të menaxhojnë skemën sociale me efektivitet, të ndjekin zbatimin e tij dhe të masin ndikimin.

69. Komiteti rekomandon që shteti palë të adresojë kondita e banimit për familjet Rome dhe të mos përdorë në të ardhmen dëbimin e detyruar.

H. Arsimi, koha e lirë dhe aktivitetet kulturore (nenet 28, 29)

Arsimimi, përfshirë trainimin profesional dhe këshillimin

71. Në frymën e komentit të përgjithshëm No. 1 (CRC/GC/2001/1), Komiteti i kërkon shtetit palë që të rrisë në mënyrë të dukshme alokimet në buxhet për sektorin e arsimit Komiteti i rekomandon shtetit palë që të marrin masat e duhura për:

- (a) Vlerësimin nëse programi i “shansit të dytë” është program efektiv dhe i qëndrueshëm në tërheqjen e fëmijëve që abandonojnë shkollën dhe në përfundimin e saj;
- (b) Investim në trainimin e mësuesve dhe për mirëmbajtjen e rinovimin e strukturave edukuese, veçanërisht në zonat rurale dhe të sigurojë se kushte të përshtatshme janë në funksion të një arsimimi të cilësishëm.
- (c) Të siguroar që arsimi i detyruar është pa pagesë për të gjithë fëmijët, përfshirë librat shkollorë, transportin për në shkollë për fëmijë të dis-advantazhuar që jetojnë në zonat rurale;
- (d) Të siguroar një akses efektiv në arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, fëmijëve me HIV/AIDS, fëmijëve Romë dhe vajzave shtatzëna;
- (e) Të siguroar se fëmijët Romë, fëmijët me aftësi të kufizuar, fëmijët e familjeve të drejtuara nga nëna si edhe fëmijët e familjeve të klasifikuara si të varfëra kanë prioritet në programe parashkollore që mundësojnë të mësuarit gjatë fëmijërisë së hershme, socializimin dhe të sigurojnë fonde të mjaftueshme për zbatimin e politikave që inkurajojnë rregjistrimin e kategorive të mësipërme në arsimin parashkollor;
- (f) Dënimin e autorëve të korrupsionit në shkolla;
- (g) Trainon mësuesit dhe zhvillon kurrikula, tekste shkollore dhe mjete ndihmëse me qëllim mundësimin e arsimit në gjuhët e minoriteteve, e veçanërisht për fëmijët Romë, dhe zhvillon njësi kurrikulash për fëmijë shkollorë, përfshirë historinë e komunitetit Romë, kulturën Romë me qëllim nxitjen e të kuptuarit, të tolerancës, dhe të respektit për të drejtat e Romëve në shoqërinë shqiptare.

I. Masa mbrojtëse të veçanta (nenet 22, 30, 38, 39, 40, 37 (b)-(d), 32-36 të Konventës)

Fëmijët e azil-kërkueve dhe refugjatëve

73. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të sigurojë se fëmijët janë identifikuar dhe regjistruar gjatë procedurave të para-identifikimit në pikat kufitare të hyrjes, nuk janë mbajtur gjatë në to dhe se procedura të përshkuara nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës janë ndërmarrë për të adresuar sa më mirë nevojat imediate dhe ato afatgjata të fëmijës. Kjo përfshin caktimin e kujdestarëve ligjor si edhe ofrimin e një informacioni të gjërë minorenëve mbi kthimin e mundshëm.

Komiteti inkurajon shtetin palë që sigurojë se Policia Kufitare nuk arreston minorenë të pashoqëruar dhe në këtë rast kërkon asistencë teknike nga Zyra e Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR). Komiteti kërkon nga shteti palë që të sigurojë se fëmijët azil kërkues dhe refugjatë kanë akses në arsim.

Fëmijët në situatë migrimi

75 Komiteti i rekomandon shtetit palë që të studiojë ndikimin e migracionit tek fëmijët siç është rekomanduar edhe më parë nga Komiteti i Punëtorëve Migrantë (CMW/C/ALB/CO/1

paragrafi 37, 2010) dhe t'ju sigurojë fëmijëve të gjitha shërbimet sociale të nevojshme me qëllim realizimin e të drejtave sipas Konventës.

Fëmijët e grupeve minoritare

77. Komiteti i kërkon shtetit palë që të fuqizojë më tej dhe zbatojë programe të ndryshme dhe strategji për fëmijët Romë, veçanërisht duke alokuar burime njerëzore dhe financiare. Komiteti gjithashtu i rekomandon shtetit palë që të amendojë Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Konditave të Jetesës për Minoritetin Romë dhe të marrë masa aktive që parandalojnë dhe luftojnë diskriminimin dhe marginalizimin e fëmijëve Romë. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të njohë minoritetin egjiptian, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje të veçantë për fëmijët të kualifikohen për këtë mbrojtje.

Shfrytëzimi ekonomik, përfshirë edhe puna e fëmijëve

79. Komiteti i kërkon shtetit palë që të fuqizojë përpjekjet për reduktimin e punës së fëmijëve, veçanërisht formave më të rënda, nëpërmjet adresimit të shkaqeve të shfrytëzimit ekonomik, nëpërmjet zhdukjes së varfërisë dhe arsimimit.

Veçanërisht Komiteti i rekomandon shtetit palë që të:

- (a) Fuqizojë inspektoriatin e Punës dhe t'i paisë inspektorët me gjithë mbështetjen e duhur, përfshirë edhe ekspertizë për punën e fëmijëve, duke i aftësuar në monitorimin efikas të zbatimit të standarteve të punës, si në nivelin shtetëror ashtu edhe atë lokal.
- (b) Sigurojë që incidenti i Gërdecit të jetë i investiguar dhe efektivisht i ndëshkuar;
- (c) Kërkojë në mënyrë të vazhdueshmë asistencë teknike nga Programi Nderkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe Zyra Ndërkombëtare e Punës.

Fëmijët në situatë rruge

1. Komiteti i kërkon shtetit palë që në bashkëpunim me OJF dhe me pjesëmarrjen e fëmijëve të:

- (a) Të fuqizojë masat për mbrojtjen, asistimin dhe largimin nga situata e rrugës së fëmijëve dhe sigurimin e një aksesit në arsimim dhe shërbime shëndetsore, duke marrë në konsideratë edhe mendimet/pikpamjet e fëmijëve;
- (b) Të fuqizojë mbështetjen për familjen, në termat e parandalimit dhe të ndihmës për kthimin e fëmijëve në familje, kur është e mundur;
- (c) Të ndërtojë programe dhe mekanizma raportimi duke ju ofruar fëmijëve në situatë rruge një informacion të përshtatshëm me qëllim mbrojtjen e tyre nga të gjëndurit si viktime të trafikimit dhe të shfrytëzimit ekonomik dhe seksual, si edhe mbështetjen dhe këshillimin e tyre;
- (d) Të garantojë që personat që përdorin fëmijët në format më të rënda të shfrytëzimit, të dënohen apo gjobiten;
- (e) Të garantojë që fëmijët në situatë rruge të mos konsiderohen dhe të mos trajtohen si të dënuar.

Shitja, trafikimi dhe pengmarrja

83. Komiteti kërkon nga shteti palë që të marrë masa rigoroze në dhënien fund të trafikimit të fëmijëve brënda apo jashtë territorit të tij. Për këtë qëllim Komiteti i kërkon shtetit palë që të:

- (a) Garantojë që Plani Kombëtar i Veprimit në Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikut (2011-2013), të adresojë masa parandaluese që targetojnë në mënyrë të veçantë fëmijët e etnive Romë dhe Egjiptian;
- (b) Marrë masa aktive në dërgimin në bankën e të akuzuarve policë dhe zyrtarë të përfshirë në trafikim;
- (c) Ndërtojë mekanizma për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve të trafikimit;
- (d) Sigurojë fëmijët viktima të trafikut në strehëza, me mbështetje dhe asistencë psikosociale me qëllim ri-integrimit dhe marrjen në konsiderate edhe të mbështetjes nga shoqëria civile e cila aktualisht është e përfshirë; dhe
- (e) Garantojë që investigime të detajuara dhe dënime të rënda tu jepen personave që kanë kryer këto vepëra penale.

Administrimi i drejtësisë për të mitur

85. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të sjellë sistemin e drejtësisë për minorenët në të njëjtën linjë me Konventën (dhe në mënyrë të veçantë me nenet 37, 39 dhe 40) dhe me standarte të tjera të rëndësishme, përfshirë Rregullat Minimum Standart për Administrimin e Sistemit të Drejtësisë për Minorenët (rregullat e Pekinit), Udhëzimet për Parandalimin e Delinkuencës minorile (udhëzimet e Riad-it), Udhëzimet e Vienës për Veprimet me Fëmijët, në sistemin e gjykatës kriminale dhe rekomadimin e përgjithshëm të Komitetit (CRC/C/GC/10, 2007).

Në mënyrë të veçantë Komiteti i rekomandon shtetit palë që të:

- (a) Ndërtojë një gjykatë të specializuar për minorenët me burime të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare në të gjithë vëndin dhe të prezantojë gjykatës të specializuar për fëmijët në të gjitha rajonet, si edhe të sigurojë që keta gjykatës të specializuar të marrin edukim dhe trainim të përshtashëm;
- (b) Garantojnë se fëmijët nuk mbahen të dënuar në komisariatet e policisë së bashku me të rriturit dhe pa praninë e një avokati dhe se të gjitha rastet e keq-trajtimit janë investiguar dhe dënuar;
- (c) Organizojë trainime të rregullta në drejtim të zbatueshmërisë së ligjit, përfshirë stafët e policisë e të burgjeve me qëllim që ata të gjithë të kenë njohuri të plota mbi kërkesat e Konventës dhe të jenë të vetëdijshëm se shkeljet janë të pa-pranueshme dhe të investigueshme dhe se autorët do t'i nënshtrohhen ndjekjes penale;
- (d) T'ju mundësojë fëmijëve viktima apo autorë, mjete ligjore apo mbështetje në fazën fillestare të procedimit, dhe gjithashtu përgjatë procesit ligjor në konformitet me Kodin e Procedurës Penale;
- (e) Të garantojë që burgimi është mjeti i fundit, dhe për një kohë sa më të shkurtër, dhe me mundësi rishikimi në mënyrë periodike me qëllim uljen e tij;
- (f) Nxitjen e formave alternative të dënimit si shërbimi i provës, këshillimi, punë në komunitet, sa herë që kjo është e mundur;
- (g) Marrjen e masave urgjente për përmirësimin e konditave të vuajtjes së dënimit në ambientet e para-burgimit për të miturit;
- (h) Të garantojë që fëmijët e privuar nga liria kanë akses në arsimim, shërbime shëndetsore, përfshirë shërbime të shëndetit mendor; dhe
- (i) Të përdorë, nëse është e aplikueshme, mekanizmat e asistencës teknike zhvilluar nga Paneli Ndër-agjensive të Kombeve të bashkuara mbi Drejtësinë Minorile dhe anëtarët e tij si

UNODC, UNICEF, OHCHR dhe OJF, si edhe të kërkojë asistencë teknike në fushën e Drejtësisë Minorile nga anëtarët e Panelit.

J. Ratifikimi i instrumentave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut

86. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të fuqizojë përmbushjen e realizimit të të drejtave të fëmijëve, ratifikimin e Protokollit Fakultativ (jo të detyrueshëm) , të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve për Proçedurat e Komunikimit ,dhe të Konventës të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Fakultativ të tij, si edhe të Protokollit Fakultativ të Konventës të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

K. Kooperimi me strukturat rajonale dhe ndërkombëtare

87. Komiteti i rekomandon shtetit palë që të koeperojë me Këshillin e Europës drejt një zbatimi të Konventës dhe instrumentave të tjera të të drejtave të njeriut, si në shtetin palë ashtu edhe në shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Europës.